



## NË KËTË NUMËR:

<i>Nisi semestri veror</i>	2
<i>Seminar për gradat e përbashkëta dhe njohjen akademike</i>	3
<i>Studentët përfunduan praktikën doganore</i>	4
<i>Vazhduan hulumtimet për të rinjtë</i>	6
<i>Platformë elektronike për institucionet e arsimit të lartë</i>	6
<i>Zyra e Karrierës në ndihmë të studentëve</i>	7
<i>Emocionet e ndeshjes direkt në "Pjetër Budi"</i>	8
<i>dhe të tjera...</i>	

## Nisi semestri veror

Në Kolegjin “Pjetër Budi” më 3 mars filloi semestri veror i vitit akademik 2013/2014. Studentët e të gjitha drejtimeve, stafi akademik dhe stafi administrativ janë të gatshëm për mbarëvajtjen e mësimit dhe punës edhe gjatë këtij semestri. Dekani i Kolegjit “Pjetër Budi”, Prof. Dr. Nuhi Rexhepi, ka uruar studentët dhe stafin me rastin e fillimit të semestrit. “Ju përshëndes me urimet më të mira për fillimin e semestrit veror të vitit akademik 2013/2014!

Uroj të keni shëndet të mirë, presim rritjen e nivelit të punës dhe të angazhimit në ligjërata, ushtrime, seminare, punë praktike, të gjitha në funksion të rritjes së cilësisë në studime”, thuhet në urimin e dekanit Rexhepi





## Seminar për gradat e përbashkëta dhe njohjen akademike

Prodekania për Çështje Akademike dhe Politika Zhvillimore e Kolegjit “Pjetër Budi”, Evliana Berani ka marrë pjesë në seminarin “Gradat e përbashkëta dhe njohja akademike”, organizuar në Prishtinë.

Qëllimi i seminarit ishte njoftimi me rolin dhe ndikimin e gradave të përbashkëta në cilësinë e përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, rregullat ligjore për programet e përbashkëta dhe përvojat evropiane në ofrimin e gradave të përbashkëta, të cilat kanë një ndikim në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike të vendit.

Përfaqësues të Zyrës Nacionale Erasmus+ kanë bërë të ditur se të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë deri më 17 mars kanë mundësi të aplikojnë në programet për studime jashtë vendit. Bashkëpunimi do të jetë i mundur vetëm ndërmjet universiteteve që kanë marrëveshje dypalëshe.

Kimete Canaj, koordinatorë e Zyrës së Tempusit në Kosovë ka thënë se ky është një program i hapur dhe i financuar nga Komisioni Evropian. Për diplomat e përbashkëta, ajo tha se Kosova ende ka punë për të bërë. Ndërkaq Drita Kadriu, këshilltare e ministrit të Arsimit, ka thënë se nëpërmjet këtij seminari pritet që përvojat e shteteve të zhvilluara të ndikojnë në arsimin e lartë dhe zhvillimin ekonomik.

Zyrtarja për politika, bashkëpunim dhe programe ndërkombëtare në Komisionin Evropian, Helene Skikos, tha se ndërtimi i kapaciteteve e burimeve njerëzore është e vetmja mënyrë që të kesh kapacitete në sektorë specifikë që më vonë sjellin të ardhura. Sipas saj, për ta ka shumë rëndësi që të përfishjnë të rinjtë në këto projekte.

Më pas është diskutuar për rolin e sistemit të arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, për diplomat e përbashkëta, si sfidë për sigurimin e cilësisë, si dhe janë sjellë përvojat nga universitete evropiane dhe amerikane. Në fund janë nxjerrë edhe rekomandime.



# Erasmus+

## Studentët përfunduan praktikën doganore

Studentët e drejtimit Doganë dhe Shpedicion gjatë muajit shkurt kanë mbajtur praktikën në pikat doganore të vendit. Të ndarë në grupe dhe të shpërndarë të pika të ndryshme, ata kanë pasur rastin të njoftohen për së afërmi me punën në Doganën e Kosovës

“Kam përshtypje shumë të mira. Kemi kaluar shumë mirë, po ashtu stafi i Doganës na ka mirëpritur. Ata kanë qenë të gatshëm në çdo kohë që t’iu japin përgjigje pyetjeve tona. Unë kam përfituar njohuri të shumta në lidhje me procesin e zhdoganimit, ndërkaq kam përvetësuar edhe njohuri në programin Asycuda, me të cilin punon Dogana e Kosovës”, thotë studenti i vitit të tretë, Kadri Durguti, i cili e ka kryer praktikën në pikën doganore të Vërmicës (Prizren).

“Më pastaj kam patur rastin të bëj kontrollimin e kontenjerëve në sektorin e shikimit, me pajisjet më të avancuara në treg, kam mësuar se si duhet kontrolluar një mall më detajisht dhe, po ashtu, kam mësuar se si kontrollohet vetura në vendkalim kufitar”, thekson ai.

Të gjithë studentët e Drejtimit Doganë dhe Shpedicion në “Pjetër Budi” e kanë të obligueshme që gjatë studimeve të kryejnë praktikën në doganë dhe praktikën në shpedicion.





## Vazhduan hulumtimet për të rinjtë

Edhe gjatë muajit shkurt grupe studentësh të Kolegjit “Pjetër Budi” janë fokusuar në hulumtimet në mesin e të rinjve, duke synuar të evidencojnë çështje që i preokupojnë ata dhe më pas, të propozojnë zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohen. Hulumtimet janë realizuar në kuadër të punës shkencore dhe praktike të studentëve.



## Platformë elektronike për institucionet e arsimit të lartë

Kolegji “Pjetër Budi” është bërë pjesë e platformës elektronike, e cila do t’iu shërbejë institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë të regjistrojnë profilin e tyre më informata bazike. Qëllimi i kësaj nisme është promovimi i institucioneve të akredituara dhe licensuara të arsimit të lartë si brenda, ashtu edhe në rajon dhe dimensionin ndërkombëtarë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e ka finalizuar këtë platformë me përkrahje të ILab nga Zyra e UNICEF-it.





## Zyra e Karrierës në ndihmë të studentëve

Me qëllim që t'u vijmë në ndihmë studentëve dhe të diplomuarve që të përmbushin synimet e tyre në karrierë, Zyra e Karrierës që funksionon tash disa vite në kuadër të Kolegjit "Pjetër Budi" ofron një shërbim të plotë menaxhimi të karrierës, duke përfshirë mbështetje në projektet dhe kërkimet e punësimit gjatë gjithë periudhës së studimeve.

Këtu përfshihen njoftime punësimi periodike, këshillime të përgjithshme për strategji në kërkim të punës, këshillim i personalizuar karriere, si edhe ndihmë konkrete apo këshilla rreth përgatitjes së CV-së.

Zyra e Karrierës ndihmon në lokalizimin e kërkimit shkencor dhe të temave për mbrojtjen e diplomave nga mjedisi i biznesit, në mënyrë që të krijojë kontakte ndërmjet këtyre dy sferave (të arsimit dhe të industrisë) dhe të krijojë lidhje të punës studimore me projekte të botës reale.

Zyra e Karrierës ndjek zhvillimet e fundit në tregun e punës, mbledh informacion për studentët e diplomuar në "Pjetër Budi", si dhe mbledh informacion për të gjetur mënyra efikase që studentët të nisin një karrierë në profesionin e tyre.

Po ashtu, kjo zyrë ndihmon për hartimin e CV-ve profesionale dhe hartimin e letrave rekomanduese apo motivuese, të cilat pasqyrojnë aftësitë dhe eksperiencën e kandidatit, ofron këshilla për të realizuar intervista të suksesshme, si dhe mundësinë e njohjes me një shumëllojshmëri pozicionesh të lira pune të cilat janë në dispozicion të studentëve.





## Emocionet e ndeshjes direkt në “Pjetër Budi”



Ndeshja futbolistike miqësore ndërmjet Kosovës dhe Haitit është transmetuar në ekranin e madh, në Amfiteatrin e Kolegjit “Pjetër Budi”. Shumë studentë, ligjërues e qytetarë të tjerë kanë përcjellë emocionet e ndeshjes historike. Përcjellja e ndeshjes në mënyrë të organizuar u mundësua nga Organizata Studentore e Kolegjit “Pjetër Budi”.